

321.7:304

Mr. Kujtim Kasami<sup>1</sup>

## SFIDAT E DEMOKRACISË LIBERALE

### ПРЕДИЗВИЦИТА НА ЛИБЕРАЛНАТА ДЕМОКРАТИЈА

### CHALLENGES OF LIBERAL DEMOCRACY

#### Abstrakt

**Demokracia** (gr. *demos* - popull, *kratia* - rend) është një formë qeverisje në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre ose drejtpërdrejtë, nëpërmjet referendumeve, ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve. Studiues të ndryshëm japin përkufizime të ndryshme për demokracinë. Por nëse i referohemi një shteti demokratik, përkufizimi më i përshtatshëm do të ishte: “Demokracia ekziston kur marrëdhëniet midis të qeverisurve dhe qeverisë i përmbahen parimit se shteti është në shërbim të qytetarëve dhe jo anasjelltas, se qeveria ekziston për popullin, dhe jo anasjelltas.”

Demokracia mund te përmblihet në:

- zgjedhje të përgjithshme të lira
- liri e organizimit
- liria e fjalës dhe e shtypit
- liria e opinionit
- barazi përpara ligjit

#### Abstract

Democracy (gr. *Demos* - people, *Kratia* - order) is a form of leadership in which the majority of people exercise have their sovereignty directly or through referenda or indirectly, electing their representatives. Different scholars give different definitions of democracy. But if we refer to a democratic state, the most appropriate definition would

---

<sup>1</sup> PhD candidate

be: "Democracy exists when the relationship between the governed and the government adhere to the principle that the state serves the citizens and not vice versa, that the government exists for the people, and not vice versa." Democracy can be summed up in:

- freedom in general elections
- freedom of organisation
- freedom of speech and press
- freedom of opinion
- equality before the law.

### **Demokracia liberale**

Demokracia liberale është një formë qeverisje, është sistem politik. Sipas Fred H. Will Hoite ("Power and Government") tiparet themelore të saj janë:

• **Ekzistenca e Kushtetutës:** e cila në thelb ndalon qeverinë të abuzojë me pushtetin. Ndarje e tre pushteteve: Legjislativ (Parlamenti), Ekzekutiv (Qeveria) dhe Juridik (Gjyqësori). Ndarja e pushteteve e bën të pamundur që njëra prej tyre të marrë aq pushtet sa që të dominojë mbi të tjerat. Secili prej pushteteve ka kompetencat e veta të qarta, por ekzistojnë mekanizma që sigurojnë kontrollin dhe balancën mes tyre.

• **Qeverisje përfaqësuese e përgjegjshme dhe llogaridhënëse:** thelbi qëndron në demokracinë elektorale, e cila u krijon mundësinë votuesve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre. Ndërkohë vendoset një lidhje mes të zgjedhurve dhe zgjedhësve dhe trysnia elektorale është e tillë që nxit përgjegjshmërinë e të zgjedhurve, si dhe llogaridhënien e tyre tek zgjedhësit.<sup>2</sup>

• **Pluralizmi partiak:** nënkupton ekzistencën e shumë partive politike e për rrjedhojë nxit konkurrencën, i ofron alternativa të shumëllojta zgjidhjesh elektoratit, produkt i së cilës janë politikat më të përgjegjshme dhe frytdhënësve që i shërbejnë elektoratit.

• **"Sundim i shumicës duke respektuar pakicën"** që nënkupton raportin mes shumicës parlamentare dhe partive në opozitë. Opozita është instrument për të kontrolluar përmbushjet e detyrave nga shumica.

• **Ekzistenca e grupeve të interesit:** të cilat sigurojnë mbrojtjen e interesave të grupeve të ndryshme të shoqërisë.

• **Liria për pjesëmarrje në politika.**

---

<sup>2</sup> <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/MANUALI%20I%20PARTIVE%20POLITIKE%202010%20I%20RIU.pdf>

• **Ndryshimet paqësore:** Ndryshimet vijnë përmes alternativave, ideve që kanalizohen në partitë e ndryshme politike të cilat të mandatuara nga vota e zgjedhësve realizojnë ndryshimet e kërkuara.

### **Sfidat e demokracisë liberale**

Një nga sfidat e para ishte sulmi ndaj liberalizmit modern në interpretimin e tij për individët si qenie të arsyeshme. Iluministët dhe liberalët vazhdimisht e vinin theksin në liritë e individit dhe njerëzit me arsye. Ata ushqenin besim të madh në arsyen, shkencën, mirësinë dhe në aftësinë njerëzore për të ndryshuar shoqërinë për të mirën e përgjithshme. Gjykimet e tyre, liberalët i lidhnin drejtpërdrejtë me qeverisjen përmes debatit, tolerancës dhe konsensusit. Për ta, të gjitha këto e kishin bazën te arsyeja. Sipas Hobsbaunit, edhe për ata që kishin jetuar në shek. XIX, “shteti dhe shoqëria duhet të frymëzoheshin nga vlerat e arsyes, debatit politik, arsimit, shkencës dhe përmirësimit”. Këto vlera ishin pjesë e mosbesimit ndaj diktaturës dhe sundimit absolutist dhe të angazhimit për qeverinë kushtetuese me apo nën asambljetë përfaqësuese të zgjedhura lirisht që garantonin sundimin e ligjit me paketën e pranuar të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, përfshirë lirinë e fjalës, të botimit dhe të tubimit. Por nga fundi i shek. XIX, në mënyrë paradoksale disa zbulime shkencore filluan të përdoren për të treguar se “njeriu nuk është vetëm qenie e arsyeshme”. Kështu, teoria e Çarls Darvinit ishte zgjeruar tej sferës në të cilën ajo ishte justifikuar dhe, rezultatet e saj shiheshin te mirëqenia edhe në rendin social edhe në atë ekonomik. Kështu, doli i ashtuquajti **darwinizmi social**.<sup>3</sup> Ai e konceptonte njeriun si qenie me aftësi “thjeshtë për t’iu përshtatur mjedisit në luftën e përjetshme për ekzistencë, ku fitonin ata që ishin më të fuqishëm”. Pikëpamje të tilla u shtrinë në aspektin e qeverisjes, fillimisht për të lartësuar individualizmin ekonomik dhe konservatorizmin politik. Biznesmenët e suksesshëm, pohonin përkrahësit e darvinizmit social, kanë provuar përshtatshmërinë e tyre në botën e konkurrencës së sipërmarrjes dhe se suksesi i tyre përputhej me ligjet e natyrës. Për ta, ata që humbasin në luftën social-ekonomike dëshmonin papërshtatshmërinë e tyre. Biologjia e Darvinit filloi të përdoret edhe për të parashtruar **epërsinë racore**. Sundimi mbi popujt e tjerë vlerësohej si “e drejtë” e racës më të mirë. Pikëpamjet e darvinizmit social jo vetëm minonin traditën iluministe e të demokracisë liberale, por qenë me

---

<sup>3</sup> Sistemet politike bashkëkohore – Llambro Filo, Po Box 1532, Tiranë, f.181

pasoja të rrezikshme për shoqërinë. Ndërsa demokratët liberalë theksonin barazinë njerëzore, darvinistët socialë e ndanin njerëzimin në raca më të larta dhe më të ulëta. Ndërsa demokratët liberalë e mbështetnin progresin në qeverisjen përfaqësuese përmes realizimit të sundimit të ligjit, tolerancës, zgjidhjes së konflikteve, darvinistët socialë vlerësonin konfliktet si domosdoshmëri biologjike, si ligje të historisë dhe mjete të progresit. **Irracionalistët**, nga ana e tyre, mohonin pikëpamjet iluministe dhe liberale për arsyen dhe progresin dhe vinin theksin “në anën irracionale të sjelljes”. Për ta, “arsyeja ushtronte ndikim shumë të kufizuar dhe se impulset, emocionet, nxitjet, nënvetëdija e sjelljes njerëzore ishin ato, që qeverisnin”. Si romantikët, mbrojtësit e irracionalizmit i besonin më shumë ndjenjave, intuitës. Figurë kryesore e justifikimit të irracionalizmit ishte filozofi gjerman Frederik Niçe (1844-1900). Shkrimet e tij nuk ishin traktate sistematike, ato kishin mjaft kundërshtime, kontradikta të brendshme që çonin në keqinterpretime, madje nazistët i bënë atyre shtrembërime flagrante, për të justifikuar teorinë e racës më të lartë gjermane. Niçe dënonte reformat sociale, qeverisjen parlamentare, të drejtën e përgjithshme elektorale, vizionin e progresit përmes shkencës dhe moralin kristian. Ai vuri në “lojë” bindjet liberale mbi mirësinë dhe qenies i arsyeshem që ishin, në thelbin e qenies së njeriut. Niçe theksonte, se “njeriu duhet ta kuptojë se jeta, e cila është mbushur plot me pabarazi, pasiguri, mizori dhe absurditet, nuk ishte qeverisur nga parime të arsyeshme”. Po ashtu, ai shtonte se “shoqëria borgjeze moderne është dekadente dhe e dobët – viktimë e zhvillimit të tepruar, të aftësive racionale për llogari të cenimit të vullnetit dhe të instinktit”. Ndaj theksimit liberal mbi arsyen dhe intelektin, Niçe kërkonte njohjen e mistereve të errëta të botës së dëshirave mbi baza instinktesh që, për të, ishin baza e vërtetë e jetës. Ai thoshte se, edhe kristianizmi me kufizimet dhe kërkesat për konformitet, shkatërronte impulset njerëzore për jetën, se morali kristian duhet të zhduket, sepse, sipas tij, ai është i përshtatshëm vetëm për të dobëtit dhe skllëverit: mësimet kristiane, përfundonte ai, e largojnë njeriun prej shprehjes së natyrës së tij instinktive. Niçe iu kundërvu pikëpamjeve të demokratëve liberalë dhe atyre të socialistëve, duke akuzuar të parët se ngrinin lart njeriun inferior dhe të dytët për “dokrra egalitare”. Për të, shoqëria evropiane ishte pa figura heroike, se të gjithë njerëzit i përkisnin “kopesë së madhe, por nuk kanë bari”. Prandaj, shkruante ai, është i domosdoshëm, njeriu më i lartë, që deklaroi luftën dhe i jep fund sundimit të njeriut më të ulët. Ndër filozofët tjerë vend të veçantë zë Sigmund Frojdi (1856-1939). Ai

identifikonte qytetërimin me arsyen dhe e vlerësonte shkencën si “bulevardi i dijes”. Por, Frojdi parashtronte ndikimin e nxitjeve të paarsyeshme. Ai pranonte “rrezikun e tyre potencial” dhe u përpoq ta shpjegojë atë në mënyrë shkencore dhe ta rregullonte në interes të civilizimit.

“Qytetërimi, thoshte ai, është përpjekur të kufizojë instinktet agresive të njeriut, por, me gjithë përpjekjet, nuk ia ka arritur qëllimit”. Ndërkaq, kishte edhe shkrimtarë, artistë modernistë, që justifikonin anën irracionale. Prej pikëpamjes se njeriu në thelb nuk është thjesht qenie e arsyeshme, ishte një hap i vogël për të mohuar arsyen dhe zgjidhjen e problemeve me tolerancë. Në vend të arsyes, bindjes, urtësisë, tolerancës, ekzaltoheshin instinktet, emocionet, vullneti, guximi për “ndërmarrjen e veprave madhështore”.<sup>4</sup> Mbi këtë bazë lavdërohej dhuna. Kjo lidhej me pranimin dhe pohimin e veprimit të masave të lëvizjeve politike masive, të grumbullimit të madh të njerëzve jashtë strukturave dhe institucioneve të qeverisjes përfaqësuese. Në fushën politike filluan të shfaqen pikëpamje të atilla, si ato që partitë ose komb – shtetet me interesa të kundërta kurrë nuk mund të merreshin vesh në mënyrë të arsyeshme mbi bazën e synimeve të përbashkëta. Nën ndikimin e pikëpamjeve të tilla, filloi të bëhet e zakonshme hedhja poshtë e argumenteve të kundërshtarëve, pa menduar më tej dhe pa ndonjë shpresë se mendimi i arsyeshëm do t’i kapërcente kundërshtitë. Kjo u shfaq në Britani me formimin e Partisë Laburiste. Partia u kërkonte anëtarëve të saj në parlament të votonin si i “dirigjonte” ajo, mbi bazën e solidaritetit partiak, gjë që u kopjua edhe nga të tjerët, Kjo vështirësonte vijën e opozitës, nuk pranonte që individët të zgjidhnin në mënyrë të lire pozicionin që do të mbanin, gjë që kufizonte rëndësinë dhe procedurat e diskutimeve parlamentare dhe zgjidhjen e problemeve me konsensus. Pikëpamjet e mësipërme u bënë edhe më të rrezikshme me pasqyrimin e tyre në politikën qeveritare përmes nacionalizmit ekstrem, militarizimit, imperializmit. Mendimtarët politikë të kohës janë shumë më pak ideologjik dhe shumë më pragmatikë se pararendësit e tyre të shekullit të kaluar. Kjo është arsyeja për të cilën modernistët e shohin demokracinë si një proces që bazohet në disa parime, duke pranuar që ekzistenca vetëm e një procesi formal nuk përbën një garanci të mjaftueshme për realizimin e një qeverisje demokratike.<sup>5</sup> **Nacionalistët ekstremë** shpreheshin kundër të drejtave të individit.

<sup>4</sup> Sistemet politike bashkëkohore – Llambro Filo, Po Box 1532, Tiranë, f.183

<sup>5</sup> <http://shtetiweb.org/2014/11/19/kuptimi-demokracise/>

Nevojat e kombit, theksonin ata, i kalojnë të drejtat e individëve. Për ta, besnikëria ndaj komb-shtetit qëndronte mbi të gjitha besimet.

Në mënyrë të veçantë nacionalistët ekstremë mohonin mendimet liberale mbi lirinë politike. Ata e shikonin lirinë politike si pengesë për forcimin dhe madhësitinë kombëtare. Mbi këtë bazë nacionalistët ekstremë, pranonin udhëheqjen autoritare si domosdoshmëri për të plotësuar nevojat e kombit. Kështu, ata e shprehnin hapur armiqësinë e tyre ndaj demokracisë liberale dhe po aq ndaj socializmit. Apeli i tyre përputhej me qëndrimet konservatore. Aristokracia e tokës, kasta ushtarake, kleri i lartë, shpesh të bashkuar me industrialistët e mëdhenj, shihnin në nacionalizmin ekstrem, instrumentin e favorshëm në luftën kundër demokracisë liberale dhe socializmit. Po ashtu, nacionalizmi modern ishte tërheqës edhe për klasën e mesme të shtresës së ulët, fshatarët që e shikonin liberalizmin dhe socializmin si kërcënim për vlerat tradicionale. Nacionalistët ekstremë, gjithashtu, mohonin idealin liberal të barazisë politike. Duke vënë kombin mbi çdo gjë, ata nuk ishin tolerantë ndaj pakicave kombëtare brenda kufijve të komb – shtetit dhe shfaqnin urrejtje ndaj popujve të tjerë. Në emër të unitetit kombëtar ata filluan të persekutojnë pakicat kombëtare brenda vendit. Ana tjetër e platformës së nacionalistëve ekstremë kishte lidhje me zgjerimin territorial jashtë kufijve ekzistues. Këtë e shihnin si shprehje të domosdoshme të kurorëzimit të madhësisë së kombit dhe të epërsisë ndaj kombeve të tjera. Në vazhdim të realizimit të këtyre synimeve, nacionalistët ekstremë vlerësonin si mjet të vetëm dhunën, luftën. Shprehje ideologjike e nacionalizmit ekstrem ishte darvinizmi social. Mbështetur në të, nacionalizmi ekstrem mori trajta të fuqishme raciste. Për nacionalizmin ekstrem “popujt në mënyrë të natyrshme ishin superior mbi të tjerët, si të bardhët mbi zezakët, nordikët mbi latinët, gjermanët mbi sllavët, antisemitët mbi hebrenjtë, dhe se klasat e larta dhe të mesme që jetonin në kushte të kënaqshme i kishin këto të mira, sepse kishin provuar se mund të përshtateshin, ndërsa klasat e varfra nuk kishin mundësi për këtë”. Kështu nacionalistët ekstrem e trajtuan racën njerëzore si çështje kyçe të zhvillimit se “ajo demonstronte fuqinë dhe arritjen e madhësisë”. Një nga shprehjet e para të nacionalizmit ekstrem ishte **antisemitizmi**, që synonte privimin nga të drejtat dhe liritë civile dhe politike të hebrenjve. Ai mori trajtën e përndjekjeve masive ndaj tyre. Kjo lëvizje binte ndesh në mënyrë flagrante me idealet e demokracisë liberale, me tolerancën dhe konsensusin. Por siç e treguan zhvillimet e mëvonshme, antisemitizmi u duhej nacionalistëve ekstremë, sepse atyre u nevojitej

patjetër qenia e armikut, rreth kundërshtimit të të cilit ata do të mobilizonin më lehtë masat e gjera për veprime jashtë parlamentit. Po ashtu, për synimet e tyre, ata lartësonin **traditën, mitet** dhe të “kaluarën e lavdishme”, të cilën e shihnin si nxitje për emocionet dhe aksionet konkrete përmes veprimeve fizike. Sfidë më e madhe për qeverisjen e demokracisë liberale ishte atëherë kur nga qeveri të veçanta prirjet ekstreme u vunë në zbatim ose u infiltruan nëpërmjet politikave qeveritare. Një prirje e tillë ishte ajo e **militarizmit**. Në kundërshtim me pikëpamjet liberale, shumë shtete evropiane e rritën kapacitetin ushtarak tej masës së domosdoshme për mbrojtjen kombëtare. Në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX fuqitë e mëdha kishin afërsisht 4.5 milionë njerëz nën armë dhe shpenzonin çdo vit më shumë se 2 miliardë dollarë. Në Gjermani militarizmi dominonte qeveritë civile. Në situatën kur mosmarrëveshjet ndërmjet shteteve rriteshin, qeveritë e kishin më të lehtë të kalonin në përdorimin e forcës për zgjidhjen e tyre. Në fund të shek. XIX u përhap shumë edhe **imperializmi i ri**, që do të thotë pushtimi dhe sundimi i një vendi ose një grupi vendesh nga një vend tjetër. Ai i hapi rrugën krijimit të perandorive kolonialiste dhe rritjes së rivalitetit midis Fuqive të Mëdha për sundimin mbi të tjerët, gjë që çoi edhe në krijimin e aleancave të fshehta. Në mes shfaqjeve të irracionalizmit, nacionalizmit ekstrem dhe militarizmit u gjallëruan forcat antidemokratike, që i mishëruan në Luftën e Parë Botërore. Lufta, mori nëpër këmbë vlerat e qytetërimit që ishte arritur deri në atë kohë dhe e futi përkohësisht qeverisjen e demokracisë liberale në krizë.

### PËRFUNDIMI

Fjala “*demokraci*” ka kuptimin e gjërave të ndryshme për persona të ndryshëm. Në fakt, ekziston shumëllojshmëri opinionesh mbi kuptimin dhe përmbajtjen e demokracisë, si dhe për kushtet e realizimit të saj, që ndryshojnë në varësi të optikës filozofike, ideologjike, politike, kulturore, sociale dhe ekonomike. Kjo shumëllojshmëri perceptimesh përfshin nga ato të planit konceptual deri në mjetet praktike të zbatimit. Ndërkaq, shumica e modernistëve të sotëm mendojnë që demokracia është rezultat i realizimit politik dhe etik: disa nënvizojnë se ajo është një luftë e vazhduar midis mbajtësve të pushtetit dhe atyre që aspirojnë ta ushtrojnë atë, ose midis sistemeve të pushtetit dhe individualitetit. Megjithëse këto koncepte nuk përjashtohen reciprokisht, ato shprehin opinione filozofike divergjente, që reflektojnë natyrën e njeriut dhe

natyrën e shoqërisë. Në të kundërtën, filozofët e kohërave të mëparshme ia atribuojnë sovranitetit të popullit, duke arsyetuar që ai ka të drejtën të krijojë dhe të rrëzoj një qeveri, sepse qeverisja është, siç ka thënë Abraham Lincoln, “prej popullit, për popullin”.

### CONCLUSION

The word "democracy" has different meanings to different people. In fact, there is a variety of opinions on the meaning and content of democracy, and the conditions of its implementation, which vary depending on the optics philosophical, ideological, political, cultural, social and economical perspective. This variety of perceptions includes from those of conceptual plan to practical tools of implementation. However, most of today's modernists believe that democracy is the result of political and ethical realism, some emphasize that it is a continuous struggle between the holders of power and those who aspire to train correct it, or between systems of power and individuality. Although these concepts are not mutually excluded, they express divergent philosophical opinions that reflect the human nature and the nature of society. On the contrary, earlier philosophers attribute to the times of the sovereignty of inhabitants arguing that it has the right to rise and to fall a government, because government is, as Abraham Lincoln said, "by the people, for the people".

### LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Sistemet politike bashkëkohore – Llambro Filo, Po Box 1532, Tiranë
- ПРОБЛЕМИТЕ НА ДЕМОКРАТСКАТА ТРАНЗИЦИЈА И КОНСОЛИДАЦИЈА (Јужна Европа, Јужна Америка и посткомунистичка Европа) од авторите Хуан Х. Линц и Алфред Степан Печати: Академски печат, Скопје 2009
- Модели на демократијата, Хелд Девид, Скопје, Академски печат, 2008
- <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/MANUALI%20I%20PARTIVE%20POLITIKE%202010%20I%20RIU.pdf>
- <http://shtetiweb.org/2014/11/19/kuptimi-demokracise/>
- <https://sq.wikipedia.org/wiki/Demokracia>